



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Titulli: Publikimi i Kornizës së Menaxhimit Mjedisor dhe Social – Projekti për lidhjen e të rinjve (PLR) në Kosovë

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është në fazën e vlerësimit të projektit **PROJEKTI PËR LIDHJEN E TË RINJVE: PËRFSHIRJA E TË RINJVE DHE NDËRMARRËSISË NË KOSOVË (PLR)** do të financohet nga Banka Botërore.

Projekti do t'i mbështesë 38 komuna për ta zgjeruar përfshirjen socio-ekonomike të grave dhe burrave të rinj të marginalizuar duke i lidhur të rinjtë me mundësitë për sigurim të të ardhurave, veprim në komunitet, qeverisje lokale dhe investime.

Kjo do të arrihet përmes trajnimit, mentorimit, lehtësimit dhe ngritjes së kapaciteteve të 7,500 të rinjve në fillimin e biznesit dhe 30,000 grave dhe burrave të tjerë të rinj, me qasje në lehtësirat e komunitetit dhe komunës si dhe zë në vendimmarrje. Projekti do t'i jep 2500 mikro grante për fillim të biznesit dhe për lehtësirat në sigurimin e të ardhurave, dhe nëngrante për lehtësirat në sigurimin e të ardhurave në nivelin komunal dhe të komunitetit.

Korniza e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS) për Projektin u përpilua si pjesë e kërkesës së politikave për masa mbrojtëse të Bankës Botërore për ta siguruar përpunimin e projektit me politikat mjedisore dhe sociale kombëtare dhe të Bankës të cilat synojnë minimizimin e risqeve të përgjithshme mjedisore dhe sociale.

Dokumenti shpaloet si pjesë e procesit të Vlerësimit të Projektit në uebsajtin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/03/ESMF_Connecting-Youth-AL-3.pdf

Si pasojë e kufizimeve për shkak të COVID 19, prezantimi publik do të bëhet virtualisht përmes platformës online të poshtëshënuar dhe platformave tjera të mediave sociale: Facebook dhe Instagram i MAPL-së. Këtu mund ta gjeni dokumentin KMMS, prezantimin në PowerPoint dhe video prezantimin. Komentet, sugjerimet dhe pyetjet lidhur me KMMS janë të mirëseardhura nga publiku i interesuar dhe mund të dorëzohen prej datës 31 mars deri më 7 prill 2020 përmes:

- Platformës Online: <https://connecting-youth-p166093.yrpri.org/community/1255>
E-mail: Edina.ibishi@rks-gov.net;
- Tel: +383 38 200 35 522
- Adresa: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ndërtesa e Qeverisë/Ish Rilindja, Recepcioni i MAPL-së, kati përdhësë;

Informatat kthyese do të jepen me shkrim për të gjitha komentet dhe pyetjet dhe do të adresohen në procesverbalin e konsultimit publik.